

VENDIM
Nr. 188, datë 13.3.2019

PËR OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË TË SHËRBIMEVE, NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE, PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE, INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE DHE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE.

(ndryshuar me VKM nr. 186, datë 27.3.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të neneve 18, 19 e 95, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si: konsulenca, studime, ekspertiza apo trajnime/edukim në vazhdim nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

2. Për shërbimet e ofruara sipas këtij vendimi, institucionet publike të arsimit të lartë zbatojnë tarifat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe, në mungesë të tyre, miratojnë tarifa me akte të brendshme. Tarifat e miratuara me akte të brendshme duhet t’u referohen kontratave për punë të ngjashme dhe, në mungesë të tyre, t’i referohen mesatares së vlerave të tregut për shërbimin përkatës të kërkuar.

3. Bordet e administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë miratojnë tarifat për shërbimet e ofruara për institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe për të tretët.

4. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nënshkruajnë kontratë shërbimi me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë.

5. Grupi i punës, mënyra e administrimit të të ardhurave dhe masa e shpërblimit të personelit akademik dhe/ose studentëve të angazhuar në ofrimin e shërbimit rregullohen me procedura të brendshme të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Përparësi në rastet e ofrimit të shërbimeve kanë ato IAL, të cilat kanë marrëveshje partneriteti me ministritë e linjës. Në rastet kur një shërbim ose kategori shërbimesh ofrohet nga më shumë se një IAL publik dhe nuk ka marrëveshje partneriteti, përzgjedhja nga ana e institucioneve publike duhet të kryhet bazuar mbi ofertën më të mirë.

7. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, vijojnë me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur:

a) cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk është sipas marrëveshjes së nënshkruar;

b) shërbimet e kërkuara nuk mund të realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë;

c) tarifat e ofruara nga këto institucione nuk janë sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Të gjitha institucionet e pavarura kanë të drejtë që, sipas nevojave të tyre, të kërkojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

9. Ngarkohen Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama